



AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
DREJTORIA E RREGULLIMIT EKONOMIK

TREGUESIT STATISTIKORE DHE FINANCIARE TE
TREGUT TE KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Viti 2010

TELEFONI CELULARE

TELEFONI FIKSE

INTERNET

Maj 2011

I.HYRJE	4
II. PANORAME E PERGJITHSHME	5
III. TELEFONIA CELULARE	12
III.1 Pjeset e tregut te operatoreve celulare	12
III.3 Trafiku telefonik	17
III.4 Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve celulare	19
IV. TELEFONIA FIKSE	21
IV.1 Numri i pajtimtareve dhe pjeset e tregut.....	21
IV.2. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom	23
V. INTERNETI	24
V.1. Numri i pajtimtareve me akses broadband ne Internet dhe struktura e tyre	24
V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura.....	27

Figura 1. Ecuria e numrit te perdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2010	6
Figura 2. Ecuria e penetrimit të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2010.....	6
Figura 3: Krahasimi Shqiperi-BE Telefoni celulare, fikse dhe akses broadband ne Internet. 7	
Figura 4. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2010).....	8
Figura 5. Ecuria e të ardhurave totale të operatorëve të komunikimeve elektronike (2008-2010)	9
Figura 6. Pjeset e tregut ne te ardhura të operatorëve alternative të komunikimeve elektronike (2010).....	10
Tabela 1. Investimet e operatoreve të komunikimeve elektronike (2010)	10
Figura 7. Shperndarja e te punesuarve ne sektorin e komunikimeve elektronike (2010).....	11
Tabela 2. Numri i te punesuarve ne sektorin e komunikimeve elektronike (2010)	11
Figura 8. Ecuria e numrit të përdoruesve celularë 2003-2010.....	12
Figura 9. Struktura e perdoruesve te telefonise celulare (2010).....	13
Figura 10: Te ardhurat dhe pjeset e tregut te operatoreve celulare (2010)	14
Figura 11: Te ardhurat e operatoreve celulare 2003-2010	15
Figura 12: Pjeset e tregut te operatoreve celulare (2010)	16
Figura 13: Trafiku dales celular sipas destinacioneve 2003-2010	17
Figura 14: Trafiku hyres celular sipas origjines 2003-2010	18
Tabela 3: Perdorimi mesatar i sherbimeve celulare 2009-2010.....	19
Tabele 4: Perdorimi i sherbimeve roaming nderkombetar 2010	20
Figura 15. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2009	22
Tabela 5 : Shperndarja e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse sipas operatoreve (2010) 22	
Tabela 6 Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve te Albtelecom 2003-2010.....	23

Figura 16. Pjeset e tregut per numrin e pajtimtarëve të aksesit broadband ne Internet 2010	25
Figura 17: Krahasimi i tarifave të aksesit broadband 2 Mbps pa limit me vendet e rajonit...	26
Tabela 9. Klasifikimi i pajtimtarëve me akses broadband sipas teknologjive 2010.....	26
Tabela 10. Ofrimi i aksesit në Internet në nivel me shumicë 2010.....	27

I.HYRJE

AKEP, me qellim informimin e publikut, paleve te interesuara dhe te sipermarresve te tregut te komunikimeve elektronike me treguesit kryesore te ketij tregu, ne vijimesi te raporteve periodike te publikuar ne faqen e Internetit te AKEP www.akep.al ne seksionin Statistika, ka pergatitur kete raport ne te cilin publikohen treguesit kryesore te tregut per vitin 2010 dhe ndryshimet me periudhat e meparshme.

Ky raport eshte pergatitur duke iu referuar te dhenave te derguara nga operatoret celulare, Albtelecom si dhe te dhenave te Operatoreve Alternative dhe Ofruesve te sherbimeve, sipas formulareve te Rregullores se te dhenave statistikore, te plotesuar nga sipermarresit e autorizuar nga AKEP.¹ Per shkak te ruajtjes se konfidencialitetit te te dhenave, jo te gjithe treguesit e raportuar nga operatoret publikohen nga AKEP.

Raporti ka natyre periodike dhe mund te pasurohet edhe me tregues te tjere apo informacion me te plote per operatoret alternative.

¹ Per shkak te problemeve te mos-dergimit te te dhenave apo te dhenave jo-te plota nga operatoret alternative, disa tregues per keta operatore bazohen ne vleresimet e AKEP.

II. PANORAME E PERGJITHSHME

Numri i sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike deri në fund të vitit 2010 ishte 196 në krahasim me 152 në fund të vitit 2009. Referuar “Regjistrin të Sipërmarrësve” në lidhje me njoftimin për ofrim rrjetesh/shërbimesh gjendja në fund të vitit 2010, rezulton:

- Ofrim shërbimi publik telefonik të lëvizshëm – 4 sipërmarrës, sa në vitin 2009;
- Ofrim shërbimit publik telefonik fiks (të qëndrueshëm) – 82 sipërmarrës, kundrejt 73 në vitin 2009;
- Ofrim shërbimi të aksesit në Internet – 116 sipërmarrës, kundrejt 89 në vitin 2009;
- Ofrim shërbimi me vlerë të shtuar – 43 sipërmarrës, kundrejt 36 në vitin 2009;
- Ofrim të linjave me qera – 37 sipërmarrës, kundrejt 29 në vitin 2009.

Gjatë vitit 2010, tregu i komunikimeve elektronike vazhdoi të rritet me ritme të larta në segmentet e telefonisë celulare dhe të internetit, ndërsa për telefoninë fikse u vu re një reduktim i numrit të përdoruesve, e shoqëruar dhe me kalim të përdoruesve nga Altelecom tek operatorët alternativë.

Në fund të vitit 2010, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme arriti në afërsisht 4.5 milion, e cila përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 140%², e cila është 11 pikë përqindje më e lartë se në vitin 2009 si edhe më e madhe se niveli mesatar prej 122% në vendet e BE në vitin 2009.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2010, sipas të dhënave të depozituara nga operatorët është 331 mijë, nivel i cili përbën një reduktim në krahasim me 338 mijë në fund të vitit 2009 (numri i pajtimtareve të telefonisë fikse të referuar nga AKEP në publikime të meparshme është rivlesuar për vitet 2007-2009). Norma e penetrimit të telefonisë fikse në Shqipëri është 10.2%, që përbën një normë shumë të ulët në krahasim me vendet e BE (me një mesatare prej 45%) dhe vendet e rajonit.

² Numri i përdoruesve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe normat e larta të përdoruesve për 100 banorë shpjegohen nga mbajtja prej një individi e më shumë se 1 kartë SIM si dhe prej përdorimit të kartave SIM nga vizitorët në një vend.

Figura 1. Ecuria e numrit te perdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2010





Figura e mëposhtëme paraqet ecurine e penetrimit (numri i perdoruesve per 100 banore³) të telefonisë celulare dhe fikse per periudhen 2003-2010, ku vihet re që telefonia fikse nuk ka pësuar ndryshime të ndjeshme për shumë vite, ndërsa është evidente rritja e telefonisë celulare.

Figura 2. Ecuria e penetrimit të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2010




³ Numri i banoreve ne Shqiperi i referohet te dhenave te Instat per numrin e popullsisë (projeksionet e REPOBA)

Deri ne fund te vitit 2010, sipas të dhënave më të fundit nga operatorët dhe vlerësimeve të AKEP numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 110 mije apo afërsisht 13.7% e familjeve, ndërsa vlerësohen të jenë mbi 10.000 pajtimtarë biznesi. Bazuar në këto të dhëna, numri i linjave broadband për 100 banorë është rreth 3.7%, krahasuar me 2.5% që ishte në fund të vitit 2009.

Normat e penetrimit të shërbimeve të telefonisë fikse dhe të aksesit apo linjave broadband janë shumë më të ulëta se në vendet e BE, megjithatë rritjen në aksesin broadband, ndërsa për telefoninë celulare norma e penetrimit është mbi nivelin mesatar të vendeve të BE.

Figura 3: Krahasimi Shqipëri-BE Telefoni celulare, fikse dhe akses broadband në Internet



Financiare

Të ardhurat totale të sipërmarrësve për vitin 2010 ishin 57087 milion lek të cilat përbejnë një reduktim prej 7.2% në krahasim me vitin 2009 kur të ardhurat ishin 61578 milion LEK. Ky reduktim i të ardhurave është në tendencë të kundërt me volumin e shërbimeve të cilat janë rritur ndjeshëm në vitin 2010 (Internet dhe telefoni celulare). Reduktimi i të ardhurave të sektorit rezultoi në këtë ardhur si pasojë e reduktimit të të ardhurave të tre operatorëve më të mëdhenj Vodafone, AMC dhe Altelecom ndërsa lojtaret e tjerë kanë rritje të të ardhurave. Kjo vëhet re edhe nga pjesët e tregut në të ardhura ku Vodafone dhe AMC kanë rritje të pjesëve të tregut, ndërsa lojtaret e tjerë kanë pasur rritje.

Kater operatorët celulare dhe Albtelecom, zoterojnë rreth 92% të ardhurave të gjithë sektorit (reduktim nga niveli 95% në 2009), ndërsa operatorët e tjerë (Operatorët Alternative) zoterojnë rreth 8% pjesë tregu (ritje nga niveli 5% në 2009). Të ardhurat e operatorëve celulare përbëjnë 73% të të ardhurave të të gjithë tregut (reduktim nga 77% e 2009), ndërsa operatori fiks Albtelecom zotëron 19% (ritje nga 18% në 2009).

Në operatorët alternative, tre sipërmarrësit me xhiro më të madhe janë Abcom, Primo dhe ASC, të cilët së bashku zënë rreth 4% të të ardhurave të sektorit (ritje nga niveli 2.5% në 2009) apo 50% të të ardhurave të të gjithë operatorëve alternative.

Figura 4. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2010)






Figura e mëposhtme paraqet tendencën e të ardhurave të sektorit dhe lojtareve kryesore në periudhën 2008-2010.

Figura 5. Ecuria e të ardhurave totale të operatorëve të komunikimeve elektronike (2008-2010)



Nder operatorët alternative që ofrojnë shërbime telefonie fikse dhe akses internet, pese operatorët me të mëdhenj, Abcom, Abissnet, Primo, Nisatel dhe ASC zënë rreth 60% të të ardhurave të të gjithë operatorëve alternative.

Figura 6. Pjeset e tregut ne te ardhura të operatorëve alternative të komunikimeve elektronike (2010)



Investimet

Per sa i perket investimeve te kryera ne vitin 2010, tabela e meposhteme paraqet te dhenat sipas deklarimeve te operatoreve.

Tabela 1. Investimet e operatoreve të komunikimeve elektronike (2010)

		2010
Operatorët Fix (Albtelecom dhe Operatore Alternative)		
Investime ne infrastrukture te rrjetit fiks (PSTN dhe IP)	milion leke	732
Investim ne infrastrukture rrjet backbone FIBER OPTIKE	milion leke	1070
Operatorët celulare		
Investime ne infrastructure rrjet celular	milion leke	8089
Investim ne infrastrukture rrjet backbone FIBER OPTIKE	milion leke	1539

Te punesuar

Numri i te punesuarve me kohe te plote nga sipermrresit e komunikimeve lektronike ne vitin 2010 ishte 4240, prej te cileve 40% ishin femra. Sipermarresi me numrin me te madh te te punesuarve eshte Albtelecom me 37% te te gjithë te punesuarve ne sektor.

Figura 7. Shperndarja e te punesuarve ne sektorin e komunikimeve elektronike (2010)




Tabela e meposhteme paraqet numrin e te punesuarve ne sektorin e komunikimeve elektronike ne fund te vitit 2010.

Tabela 2. Numri i te punesuarve ne sektorin e komunikimeve elektronike (2010)


	Operatore Celulare	Albtelecom	Operatore Alternative	Total
Te punesuar me kohe te plote	1,566	1,588	1,086	4,240
Prej te cileve femra	844	602	274	1,720

III. TELEFONIA CELULARE

III.1 Pjeset e tregut te operatoreve celulare

Në fund të vitit 2010, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme arriti në afërsisht 4.5 milion, e cila përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 140%⁴. Norma vjetore e rritjes së numrit të përdoruesve ishte rreth 9% (rreth 360 mijë përdorues më shumë), që është shumë më e ulët se norma e rritjes vjetore prej 41% në vitin 2009 apo dhe me vitet e mëparshme. Rënia e normës së rritjes si dhe numri i lartë i përdoruesve për 100 banorë përbëjnë shenja se ky treg po i afrohet fazës së saturimit. Gjatë vitit 2010 rritje më të madhe ka pasur Eagle Mobile me 37% ndërsa AMC me 6%, ndërkohë që numri i përdoruesve të Vodafone është rritur në masë shumë të vogël. Përdoruesit me parapagim vazhdojnë të përbëjnë më shumë se 90% të përdoruesve celulare dhe kjo strukturë abonentësh është e ngjashme në të katër operatorët. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë në periudhën 2003-2010

Figura 8. Ecuria e numrit të përdoruesve celularë 2003-2010



⁴ Numri i përdoruesve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe normat e larta të përdoruesve për 100 banorë shpjegohen nga mbajtja prej një individi e më shumë se 1 kartë SIM si dhe prej përdorimit të kartave SIM nga vizitorët në një vend.

Struktura e perdoruesve celulare, ne perdorues me parapagim dhe me pas-pagim (kontrate), vazhdon te jete e qendrueshme dhe ne vitin 2010, ku numri i perdoruesve me kontrate ne raport me numrin total te perdoruesve celulare, eshte afersisht 8%. Struktura e perdoruesve eshte e ngajshme te te kater operatoret celulare, megjithese Eagle Mobile ka rreth 12% te perdoruesve me kontrate ndersa me pak ka Plus qe ka rreth 5% te perdoruesve me kontrate.

Figura 9. Struktura e perdoruesve te telefonise celulare (2010)





Tabela e meposhteme parqet te dhena per vitin 2010, mbi numrin e pajtimtareve celulare te detajuar ne abonente Familjare dhe Biznes si dhe perdoruesit e sherbimeve te aksesit ne Internet dhe pajtimtaret qe kane nderruar program tarifor Brenda te njetit operator.

	AMC	VF-AL	EAGLE	PLUS	Total
Numri pajtimtareve te telefonise mobile ne total i detajuar:	2,022,541	1,674,748	822,356	28,162	4,547,807
Perdorues familjare	1,906,559	1,632,057	624,991	27,074	4,190,681
Perdorues biznes	115,982	42,691	197,365	1,088	357,126
Numri i pajtimtareve qe perdorin rrjetin celulr per akses ne internet me GPRS/EDGE	710,000	143,542	276,979	27,433	1,157,954
Numri i Pajtimtareve qe kane nderruar program tarifor ne rrjetin celular	na	93,339	277,062	na	370,401

Të ardhurat totale të tre operatorëve celularë gjatë vitit 2009 ishin 47.2 miliard lek, që përbën një reduktim me 3.6% në krahasim me vitin 2008, kur të ardhurat ishin 48.9 miliard leke. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e të ardhurave të operatorëve celularë, ku vihet re se në vitin 2009 për herë të parë u vu re reduktim i të ardhurave të sektorit.


Te ardhurat totale të katër operatorëve celularë gjatë vitit 2010 ishin 41.9 miliard leke, që përben një reduktim prej 11% në krahasim me vitin 2009, kur të ardhurat ishin 47.2 miliard leke. Rënia e të ardhurave të këtij segmenti të tregut ka ardhur si rezultat i rënies së të ardhurave të AMC (18%) dhe Vodafone Albania (12%), të cilët pësuan njëkohsisht rënie akoma më të ndjeshme të fitimit bruto dhe neto me 40-60% krahasuar me vitin 2009. Nderkohe të ardhurat e Eagle Mobile janë rritur (18%), duke rritur pjesën e tregut të Eagle Mobile nga 9% në vitin 2009 në 12% në vitin 2010.

Figura 10: Të ardhurat dhe pjesët e tregut të operatorëve celularë (2010)




Në figurën e mëposhtme paraqitet tendenca e të ardhurave celularë në periudhën 2003-2010, ku mund të vihet re në vitin 2010 ka pasur një rënie të konsiderueshme të të ardhurave në krahasim me vitin e mëparshëm 2009, i cili ishte viti i parë që shënoi rënie të të ardhurave të këtij segmenti të tregut.

Figura 11: Te ardhurat e operatoreve celulare 2003-2010



Pjesët e tregut të operatorëve celularë kanë vazhduar të ndryshojnë, ku kryesisht ka pasur reduktim të pjesëve të tregut të AMC dhe Vodafone dhe rritje të pjesëve të tregut të Eagle Mobile. Në fund të vitit 2010, Eagle Mobile ka arritur në 18% pjesë tregu për përdorues (27% për përdorues më kontratë), 12% ne te ardhura dhe 9% për thirrje dalëse dhe SMS. Plus Communication si operator i ri ka arritur 1% pjesë tregut në numër përdoruesish në rreth 1 muaj aktivitet (fundi i muajit nëntor deri në fundin e vitit). Figurat e mëposhtëme paraqesin pjesët e tregut për vitin 2010 për disa tregues kryesorë.


Figura 12: Pjeset e tregut te operatoreve celulare (2010)



III.3 Trafiku telefonik


Gjatë vitit 2010 thirrjet dalëse të përdoruesve celularë janë rritur në masë të konsiderueshme me 85% në krahasim me vitin 2009, ndërsa terminimi i thirrjeve hyrëse nga rrjetet e tjera dhe numri i SMS-ve kanë shënuar rënie të vogla. Ne Fig.13 është pasqyruar trafiku telefonik i gjeneruar nga operatorët e rrjeteve celulare i detajuar sipas destinacionit të thirrjeve: brenda rrjetit, drej rrjeteve të tjera celulare, rrjete fikse dhe nderkombetare. Ne vitin 2010 nga rrjetet celulare janë origjinuar rreth 4.2 miliard minuta, e cila përben një rritje prej 85% në krahasim me vitin 2009. Vihet re se trafiku brenda rrjetit ka rritje të ndjeshme vjetore që prej vitit 2007 dhe kjo rritje ka vazhduar dhe në vitin 2010, ku thirrjet brenda rrjetit përbejnë 92% të thirrjeve të origjinuara nga përdoruesit celularë, që përben një rritje të konsiderueshme në krahasim me periudhën 2003-2006 në të cilin ky tregues ka qenë në nivel afërsisht 50%. Rritja rezultoi të ketë ardhur si rezultat i ofertave dhe programeve të shumta tarifore që ofrojnë thirrje brenda grupeve me tarifa shumë të ulëta. Thirrjet drejt numrave gjeografike dhe numrave të emergjencës përbejnë një pjesë shumë të vogël të thirrjeve dalëse.

Figura 13: Trafiku dales celular sipas destinacioneve 2003-2010



Ne Fig.11 eshte pasqyruar trafiku telefonik hyres ne rrjetet e tre operatoreve celulare i detajuar sipas origjines se thirrjeve: nga rrjete te tjera celulare, rrjete fikse dhe nderkombetare (nuk jane perfshire thirrjet brenda rrjetit). Ne vitin 2010 ne rrjetet lulare jane terminuar 869 milion minuta, e cila perben nje reduktim me 5% ne krahasim me vitin 2009. Vihet re se struktura e ketyre thirrjeve ka qene e qendrueshme ne vite dhe ne vitin 2010, nuk ka ndryshime thelbesore. Trafiku nderkombetar hyres, vazhdon te zeje peshen kryesore ne trafikun total hyres me mbi 70%.

Figura 14: Trafiku hyres celular sipas origjines 2003-2010



III.4 Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve celulare

Ne vijim eshte dhene nje tabele me te dhena per perdorimin mujor per perdorues celulare. Perdorimi mesatar mujor per perdorues eshte llogaritur sipas thirrjeve dalese (thirrje qe gjenerohen nga nje perdorues) dhe thirrjeve hyrese (thirrjet e marra nga nje perdorues), te matura ne minuta. Keta tregues jane llogaritur per te gjithë trafikun e gjeneruar dhe marre gjate periudhes pjestuar me numrin mesatar te perdoruesve gjate periudhes (mesatarja e numrit te perdoruesve ne fillim dhe ne fund te periudhes). Thirrjet dalese perfshijne gjithë trafikun e origjnuar nga perdoruesit celulare ndersa thirrjet hyrese perfshijne thirrjet e marra nga perdoruesit, nga rrjete te tjera dhe nga i njeti rrjet. Perdorimi mujor i SMS i referohet vetem mesazheve te derguar. Keto te dhena paraqiten ne tabelen e meposhtem per perdorimin mesatar te nje perdoruesi celular, i perlllogaritur me te dhenat e tre operatoreve celulare. Ne vitin 2010 ka vazhduar tendenca e rritjes se ndjeshme te perdorimit mesatar te thirrjeve telefonike qe ka filluar ne vitin 2009. Ne vitin 2010, nje perdorues celular ka kryer mesatarisht 80 minuta thirrje dalese dhe ka marre 91 minuta thirrje hyrese, duke rezultuar ne 171 minuta komunikim ne muaj (43% me shume se ne vitin 2009) dhe ka derguar rreth 10 SMS ne muaj (28% me pak se ne 2009).

Tabela 3: Perdorimi mesatar i sherbimeve celulare 2009-2010

	2009	2010	Ndryshimi %
Thirrje dalese ne muaj	53	80	+52%
Thirrje te marra (hyrese) ne muaj	67	91	+35%
MOU ⁵	120	171	+43%
SMS (dalëse) ne muaj	14	10	-16%

Rritje më të mëdha të përdorimit të shërbimeve janë vënë re për përdoruesit e Vodafone, të cilët gjatë vitit 2010 kanë kryer mesatarisht 92 minuta telefonata dalëse në muaj dhe rreth 200 minuta komunikim telefonik (thirrje dalëse dhe të marra) në muaj.

1. Roaming Nderkombetar

Tabela e meposhteme paraqet perdorimin e sherbimeve roaming, nga te cilate vihet re se:

⁵ Minutes Of Use: Minuta perdorimi të matura me shumën e thirrjeve dalëse dhe hyrëse.

- Numri i aboneteve te rrjeteve Shqiptare qe kane perdorur roaming nderkombetar gjate vitit 2010 ishte rreth 550 mije apo 12% e perdoruesve celulare, qe eshte rreth 5 here me i vogel se numri i vizitoreve (abonente te rrjeteve te huaja) qe kryejne roaming ne Shqiperi (rreth 2.7 milion);
- Konsumi i sherbimeve gjate kohes ne roaming eshte i vogel dhe perdorimi i tyre eshte perseri me i vogel se perdorimi nga vizitoret e rrjeteve te huaja ne Shqiperi.

Tabele 4: Perdorimi i sherbimeve roaming nderkombetar 2010

	2010
Perdorimi nga pajtimtaret e rrjeteve Shqiptare i Roamingut Nderkombetar	
Numri i pajtimtareve	549,703
Perdorimi nga pajtimtaret e rrjeteve te huaj gjate Roamingut Nderkombetar ne Shqiperi	
Numri i pajtimtareve	2,703,290

2. Mesazhe MMS

Perdorimi i sherbimeve MMS eshte ne nivel shume te kufizuar me rreth 930 mije MMS te derguara dhe te marra nga abonetet gjate 12 muajve, qe perben konsum shume te vogel mujor.


Rritja e ndjeshme e numrit të pajtimtarëve/përdoruesve celulare, reduktimi i të ardhurave totale dhe normave te fitimit të dy operatorëve celularë me te medhenj, rënia e cmimeve dhe të ardhurave mesatare për përdorues, rritja e ndjeshme e përdorimit mesatar të shërbimeve celulare gjatë viteve 2009 dhe 2010 në krahasim me vitet e mëparshme, janë tregues të qartë të rritjes së përfitimeve të abonentëve celularë nga konsumi i shërbimeve celulare.

IV. TELEFONIA FIKSE

IV.1 Numri i pajtimtareve dhe pjeset e tregut

Telefonia fikse në ndryshim nga telefonia celulare dhe Interneti, ka pësuar ndryshime shumë të vogla në numrin e pajtimtarëve, dhe vazhdon të ketë një penetrim shumë të ulët. Në fund të vitit 2010, numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse arriti në rreth 332 mijë, nivel i cili përbën një reduktim në krahasim me 338 mijë që ishin në fund të vitit 2009. Ky reduktim erdhi si rezultat i reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me rreth 15 mijë abonente apo 5% të numrit total, që përbën një tendencë të kundërt me rritjen e madhe në vitin 2009, (rritja më madhe në vitet e fundit). Ndërkohë në këtë periudhë ka një rritje të ndjeshme të numrit të pajtimtarëve nga operatorët alteranativë me rreth 8 mijë pajtimtarë: nga 45 mijë në fund të vitit 2009 në 53 mijë në fund të vitit 2010. Kjo tregon se gjatë vitit 2010, ka pasur kalim të pajtimtarëve të Albtelecom tek operatorët alternative që tregon se operatorët alternativë kanë arritur të konkurrojnë me Albtelecom në terma të cmimeve dhe cilësisë së shërbimeve. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2010, sipas të dhënave të depozituara nga operatorët është 332 mijë, apo 10.2% penetrim, që përbën një normë shumë të ulët në krahasim me vendet e BE (me një mesatare prej 45%) dhe vendet e rajonit. Megjithë rënien e numrit të pajtimtarëve në vitin 2010, Albtelecom zotëron rreth 84% të këtij tregu me rreth 278 mijë pajtimtarë ndërsa operatorët alternativë rreth 16% me rreth 53 mijëpajtimtarë. Në raportet dhe publikime të mëparshme të AKEP, numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse për operatorët alternativë është bazuar në të dhënat e dërguara nga operatorët dhe në vlerësime të AKEP, për shkak se një numër i konsiderueshëm operatorësh alternativë nuk kanë qënë korrekt në dërgimin e të dhënave në AKEP. Për shkak të përmirësimit të dërgimit të informacionit nga operatorët alternativë, të dhënat e referuara në këtë raport për vitin 2010 i referohen të dhënave të depozituara nga operatorët (50 OA), dhe bazuar në këto të dhëna AKEP ka gjykuar të nevojshme të bëjë korrigjime të vlerave të raportuara për këta operatorë duke filluar nga viti 2007, pasi vlerësimi për numrin e pajtimtarëve të OA për periudhën 2007-2010 (gjashtëmujori i parë), duket se ka qënë më i madh se numri real i pajtimtarëve të këtyre operatorëve.

Figura 15. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2010



Sipas të dhënave Abcom, ASC, Nisatel dhe Primo janë kater operataoret alterantive me të medhenj që zoterojnë 50% të numrit të pajtimtareve të telefonisë fikse të operatoreve alternative.

Tabela 5 : Shpërndarja e numrit të pajtimtareve të telefonisë fikse sipas operatoreve (2010)

	Altelecom	Abcom	ASC	Nisatel	Primo	OA të tjere	Total
Numri i pajtimtareve	277,763	13,128	6,337	4,500	3,345	26,429	331,502

Altelecom zotëron pjesë tregu mbi 80% të thirrjeve dhe në të ardhura për sektorin e telefonisë fikse. Thirrjet dalëse të përdoruesve të Altelecom janë kryesisht thirrje lokale, 80% e tyre, ndërsa thirrjet ndërkombëtare zënë afërsisht 10%.

Operatorët alternativë kanë zgjeruar zonat e tyre të operimit dhe janë të përqendruar kryesisht në zonat më urbane dhe zonat rurale në afërsi të qyteteve. Struktura dhe niveli i tarifave të këtyre

operatorëve është i ngjashëm me ato të Albtelecom. Një numër operatorësh alternativë ofrojnë njëkohësisht shërbime të telefonisë fikse, akses në Internet dhe TV. Ndër operatorët alternative bie në sy Abcom që ka pasur një rritje të madhe në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2010 të numrit të pajtimtarëve me paketa dyfishe dhe tre-fishe (internet, telefoni dhe TV), duke arritur mbi 13 mijë pajtimtarë dhe duke bërë që të jetë zotërues i rreth 4% të tregut të telefonisë fikse dhe rreth 11% në akses Internet broadband.

IV.2. Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Albtelecom

Ne tabelen 6, paraqiten disa tregues konsumi mujor të thirrjeve të përdoruesve të Albtelecom. Përdorimi është matur sipas trafikut total dalese dhe hyres (thirrje të marra përfshijne edhe thirrjet brenda rrjetit Albtelecom, lokale dhe kombetare), pjestuar me numrin mesatar vjetor të përdoruesve të Albtelecom. Rreshti i fundit paraqet totalin e minutave të komunikimit (Minutes of Usage-MOU) nga një përdorues i Albtelecom, thirrje dalese dhe të marra.

Nga tabela vihet re se konsumi i thirrjeve dalese është në trend zbritës deri në fund të vitit 2009, por në vitin 2010 është vënë re një rritje në thirrjet dalese totale si dhe në thirrjet e marra (hyrese), e cila reflektohet edhe tek MOU, duke ndryshuar trendin që ishte në rënie deri në fund të 2009 dhe për vitin 2010 kemi një rritje të MOU.

Tabela 6 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Albtelecom 2003-2010

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Thirrje dalese	296	187	227	239	180	164	136	151
Lokale dalese	256	154	193	206	149	136	112	112
Mobile	14	12	13	12	12	11	10	7
Kombetare drejt fiks	18	12	13	13	12	9	41	21
Nderkombetare	9	9	9	7	7	6	5	4
Thirrje të marra	314	207	242	255	205	191	181	204
MOU	610	394	469	493	386	355	317	356

Mesatarisht konsumi i thirrjeve të kryera është 144 minuta në muaj thirrje dalese si dhe 204 minuta në muaj thirrje të marra, që do të thotë që një përdorues i Albtelecom gjatë vitit 2010 ka shpenzuar mesatarisht 356 minuta apo afërsisht 6 ore në komunikim me telefon fiks.

V. INTERNETI

V.1. Numri i pajtimtareve me akses broadband ne Internet dhe struktura e tyre

Sipas të dhënave më të fundit nga operatorët dhe vlerësimeve të AKEP numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 110 mijë apo afërsisht 13.7% e familjeve, ndërsa vlerësohen të jenë mbi 10.000 pajtimtarë biznesi. Bazuar në këto të dhëna, numri i linjave broadband për 100 banorë është rreth 3.7%, krahasuar me 2.5% që ishte në fund të vitit 2009.

Ndarja e tregut për ofruesit e shërbimit të Internetit, ndërmjet Altelecom dhe ofruesve të tjerë të këtij shërbimi, (bazuar në të dhënat e Altelecom si dhe në një vlerësim të AKEP për të dhënat e ofruesve të tjerë të këtij shërbimi), rezulton që Altelecom zotëron rreth 59% pjesë tregu për numrin e pajtimtarëve. Ndër operatorët alternativë operatori ABcom rezulton me numrin më të madh me rreth 13 mijë apo 11% pjesë tregu për akses broadband.

Numri i pajtimtarëve (lidhjeve) broadband nëpërmjet ADSL të Altelecom, deri në fund vitit 2010 është rreth 70 mijë pajtimtarë nga të cilët rreth 6% të tyre janë pajtimtarë biznes, kurse të tjerët janë pajtimtarë familjare. Gjatë vitit 2010 numri i pajtimtarëve me akses broadband në Internet të Altelecom, është rritur me rreth 20 mijë apo 35% krahasuar me fundin e vitit 2009.

Teknologjia kryesore vazhdon të jetë ADSL dhe operatori kryesor është Altelecom, i cili ka qenë shumë aktiv në shërbimet e aksesit në Internet, nëpërmjet investimeve në rrjetin lokal për të mundësuar ofrimin e shërbimit broadband nëpërmjet ADSL dhe reduktimit të tarifave për këtë shërbim. Nga të dhënat e raportuara vihet re se një numër i konsiderueshëm i lidhjeve broadband nga operatorët alternativë kryhet me kombinim fibër optike, kabëll koaksial apo linjë bakri. Ndërkohe rreth 87% e abonentëve ADSL të Altelecom përfitojnë akses në Internet me MSAN ku lidhja nga centrali telefonik deri në kabinet është me fibër optike dhe më pas me linjë bakri, e cila mund të konsiderohet si FTTN (Fiber To The Node).


Numri i abonentëve të Altelecom që përdorin Internet me Dial up ka rënie të ndjeshme duke arritur në rreth 1200, krahasuar me 14 mijë në fund të vitit 2009. Kjo rënie mund të shpjegohet me rritjen e ndjeshme të alternativave për akses broadband në Internet.

Në këtë periudhë edhe operatorët celularë kanë qënë shumë aktivë në ofrimin e shërbimeve të Internetit nëpërmjet aparateve celulare dhe kartave modem për PC, duke ofruar reduktime të ndjeshme të tarifave të këtij shërbimi për përdorues me kontratë dhe me parapagim. Në fund të vitit 2010, numri i pajtimtarëve celularë (me kontratë dhe me parapagim) që kanë akses në Internet nëpërmjet aparatit celular me GPRS/EDGE është rreth 1.2 milion përdorues, ndërsa nuk ka ende të dhëna për aksesin broadband 3G. Vodafone Albania filloi menjëherë ofrimin e shërbimeve 3G në Tiranë dhe Durrës duke realizuar detyrimin brenda periudhës 2 mujore të marrjes së autorizimit.

Ndër operatorët alternative Abcom, ASC, Abissnet, Primo dhe Nisatel kanë 82% të numrit total të pajtimtareve të aksesit Internet broadband të gjithë operatorëve alternative, apo 37%

te te gjithë tregut. Figura e meposhteme paraqet shperndarjen e pajtimtareve te aksesit broadband ne Internet (pjeset e tregut) sipas operatoreve ne fund te vitit 2010.

Figura 16. Pjeset e tregut per numrin e pajtimtarëve të aksesit broadband ne Internet 2010⁶



Gjatë vitit 2010, janë vënë re dhe disa ndryshime cilësore në ofrimin e aksesit broadband në Internet:


- ♦ **Rritje e shpejtësisë së aksesit në Internet broadband ADSL** nga intervali 256kbps-2mbps në 2mbps-12mbps, ku shpejtësia minimale dhe me e përdorur është 2mbps krahasuar me 256 kbps në 2009.
- ♦ **Konektiviteti me Internetin Global (lidhjet direkte ndërkombëtare)** është rritur nga rreth 6 Gbps në fund të vitit 2009, në rreth 14 Gbps në fund të vitit 2010.
- ♦ Ofrimi i paketave të kombinuara: Internet, TV dhe Telefoni nga OA

Gjate vitit 2010 eshte vene re **reduktim i ndjeshem i tarifave per aksesin broadband**. Nga krahasimi rezulton se tarifat aktuale të aksesit broadband në Internet, për shpejtësinë 2 Mbps pa

⁶ Te dhenat sipas te dhenave te depozituara nga operatoret per numrin total (111623) te pajtimtareve te aksesit broadband ne Internet.

limit, në Shqipëri janë në nivelin mesatar ose në nivel më të ulët se vendet e rajonit (për inkumbent dhe operatorët alternative).

Figura 17: Krahasimi i tarifave të aksesit broadband 2 Mbps pa limit me vendet e rajonit



Ky përbën një përmirësim të ndjeshëm me vitet e mëparshme kur tarifa për akses 2 Mbps ishte në nivelin më të lartë në rajon. Tarifat për aksesin broadband me kapacitete të kufizuara download janë më të ulëta, p.sh. tarifa më e ulët për 2mbps nga Altelecom është 999 lek/muaj, pakete e cila aktualisht përdoret nga shumica e abonentëve broadband të Altelecom.

Tabela 9. Klasifikimi i pajtimtarëve me akses broadband sipas teknologjive 2010

	Alternative	Altelecom	Total
DSL (mbi linje bakri)	14684	8841	23525
Kombinim Fiber/kabell koaksial/linje bakri:	15600	61743	77343
Cable Modem	10381	-	10381
Shpejtesia e aksesit në Internet	256 kbit/s- 20 Mbit/s	2 Mbit/s-12 Mbit/s	

Shpejtesia me e perdorur	1 Mbit/s	2 Mbit/s	
Numri i pajtimtareve qe kane akses ne sherbime te integruara:			
Internet dhe Telefoni	17377	70618	
TV, Internet dhe Telefoni	1137	0	120

V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura

Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa të dhëna për ofrimin e aksesit në Internet në nivel me shumicë (ofrimi per Hotspot, Internet kafe dhe lidhja me Boten) si dhe infrastrukturën e ndërtuar nga operatorët Alternative dhe Albtelecom. Nga të dhënat vihet re se konektiviteti me Internetin Global është rritur nga rreth 6 Gbps në fund të vitit 2009 në 14 Gbps në fund te vitit 2010. Sipas të dhenave të ISP-ve, për vitin 2010, numri i pikave Wi-Fi Hot Spots vlerësohet të jetë rreth 1400, ndërsa numri i Internet kafeve rreth 1000.

Tabela 10. Ofrimi i aksesit në Internet në nivel me shumicë 2010

	Alternative	Albtelecom	Total
Numri i pikave publike ëireless (WLAN apo WiFi Hotspots)	1400	0	1319
Numri i Internet Kafe	465	533	998
Konektiviteti me Internetin Global (nderkombetar)	6.2 Gbps	8 Gbps	14 Gbps
Fibër Optike e instaluar (gjatesia)	631 km	1530 km	2161 km